



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.05.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Raportit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor 2019”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e Raportit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor 2019”.

Mbledhja plenare e datës 5 maj 2020 fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit, zonjës Naureda Llagami e cila prezanton 4 pikat e rendit të ditës.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Naureda Llagami.

Merr fjalën zonja Naureda Llagami e cila relatton projekt-raportin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor 2019 i cili është hartuar nga një grup pune i ngritur për këtë qëllim në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Projekt-raporti jep një përshkrim analitik dhe të detajuar sipas indikatorëve të performancës së situatës dhe të funksionimit të sistemit gjyqësor bazuar edhe në të dhënat

e raportuara nga gjykatat.

Projekt-raporti përbëhet nga 8 kapituj duke shprehur rezultatet e Këshillit nëpërmjet shifrave, analizës narrative dhe gjetjeve për secilin kapitull.

Përgjithësisht çështjet e trajtuara në projekt-raport janë:

Veprimtaria e KLGJ-së e cila shfaqet përmes veprimtarisë së Komisioneve të Përhershme dhe të Përkohshme dhe vendimmarrjeve respektive;

Burimet njerëzore të KLGJ-së, ku vëmendje të veçantë marrin procesi i rekrutimit, ngritjes së kapaciteteve profesionale si dhe krijimi i databazave elektronike;

Bashkëpunimi ndërinstytucional, bashkëpunime të Këshillit me institucione të tjera shtetërore, shoqërinë civile, organizata dhe misione ndërkombëtare, qëllimi i të cilave është përfitimi i praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare dhe rajonale për të garantuar një sistem gjyqësor të pavarur dhe me integritet;

Transparenca në vendimmarrjen e Këshillit – Qasja e Këshillit për të funksionuar si një institucion i hapur dhe transparent; Organizimi i mbledhjeve të hapura plenare; Miratimi i programit institucional të transparencës; Caktimi i anëtarit të KLGJ-së përgjegjës për marrëdhëniet me publikun si dhe caktimi i gjyqtarëve për median, janë disa nga vendimmarrjet e Këshillit të cilat gjejnë reflektim të plotë në këtë pjesë të raportit;

Vlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe masat e marra nga Këshilli me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së sistemit, ofron një panoramë të qartë të punës së Komisionit të Përkohshëm të krijuar në mbështetje të këtij procesi;

Harta e re gjyqësore gjithashtu zë një pjesë të rëndësishme në raport. Hapat e ndërmarrë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim i cili synon bërjen realitet të propozimit për riorganizimin e kompetencave lëndore dhe tokësore të gjykatave të vendit pasqyrohen në këtë projekt-raport;

Sistemi i menaxhimit të çështjeve ofron një tablo të qartë lidhur me aplikimin, funksionimin dhe problematikat e evidentuara në zbatimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, të cilat kanë një rol thelbësor në rritjen e efijencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore;

Rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë, është nga çështjet me ndjeshmërinë më të

lartë në opinionin publik dhe për rrjedhojë është trajtuar si kapitull i veçantë i këtij projekt-raporti. Masat e marra nga KLGJ-ja në kuadër të reduktimit të numrit të çështjeve të mbartura në këtë gjykatë, procesi dhe vendimmarrja e Këshillit lidhur me propozimin për emërim të kandidatëve jomagjistratë, janë disa nga çështjet e trajtuara me përparësi në këtë kapitull;

Krijimi Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe funksionalizimi i plotë i tyre përmes procesit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe problematikat e evidentuara me këtë proces janë disa nga çështjet e analizuara në projekt-raport;

Situata e sistemit gjyqësor, e cila ofron një analizë të thelluar sasiore dhe cilësore mbi nivelin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë që jepet në 38 gjykatat e vendit për vitin 2019. Qëllimi i kësaj analize është matja dhe interpretimi i treguesve të performancës së gjyqësorit me synim evidentimin e nevojave për përmirësimin e punës dhe ofrimin e një drejtësie cilësore dhe pa vonesa për qytetarët;

Veprimtaria buxhetore dhe financiare e KLGJ-së dhe sistemit gjyqësor, vjen e trajtuar përmes shpenzimeve në zëra operative, personeli dhe kapitale. Analiza e thelluar e shpenzimeve sipas këtyre zërave hedh dritë mbi nevojat buxhetore të sistemit gjyqësor që do të garantojnë përmirësime cilësore në funksion të ofrimit të një shërbimi efikas, transparent e të shpejtë për publikun;

Në projekt-raport janë theksuar veçanërisht sfidat dhe problematikat, masat e ndërmarra dhe arritjet e deritanishme, duke përmendur që:

Gjatë vitit 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka organizuar 57 mbledhje plenare dhe ka miratuar 315 vendime, prej të cilave 286 kanë qenë iniciativë propozuese e komisioneve të përhershme.

Për të trajtuar çështje të veçanta, të cilat kërkonin fleksibilitet vendimmarrjeje dhe shpejtësi veprimi, KLGJ-ja ka krijuar 6 Komisione të Përkohshme.

Këshilli ka miratuar Planin e tij të parë Strategjik 2019-2020 duke përcaktuar pritshmëritë, prioritetet dhe disiplinuar veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim zbatimin e reformës në drejtësi.

KLGJ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ka

deklaruar fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, proces i shoqëruar me caktimin në mënyrë të përhershme të 5 gjyqtarëve dhe në mënyrë të përkohshëm të 13 gjyqtarëve, të cilët vinin nga Gjykatat e Krimeve të Rënda.

KLJGJ-ja ka hartuar dhe miratuar akte nënligjore të nevojshme për plotësimin e trupës së Gjykatës së Lartë duke i hapur rrugë fillimit të procesit të përzgjedhjes për emërimin e kandidatëve në këtë gjykatë nga radhët e juristëve të spikatur, duke përfunduar me dekretimin për emërim nga Presidenti i Republikës i 3 prej kandidatëve të kualifikuar, vlerësuar dhe renditur nga KLJGJ-ja. Krahas plotësimit të numrit të gjyqtarëve, ngritja e Komisionit të Përkohshëm me fokus reduktimin e stokut të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë është një tjetër mekanizëm përmes të cilit KLJGJ-ja po ndërhyr me qëllim trajtimin e shpejtë të çështjeve gjyqësore. Komisioni i ka propozuar KLJGJ-së një plan masash nëpërmjet një Memorandumi Mirëkuptimi, midis KLJGJ-së dhe USAID-it.

KLJGJ-ja është angazhua gjithashtu në kuadër të vettingut për të ngritur Komisionin e Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit, duke miratuar rregullat për të garantuar vijueshmërinë e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar. Komisioni ka hedhur 104 shorte, dhe ka përpunuar, relatuar dhe dërguar pranë KPK-së 99 raporte të analizimit të aftësive profesionale, që përbën 1/5 e totalit të subjekteve, duke trajtuar dhe analizuar rreth 495 dosje gjyqësore. Ndërkohë në total, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë dorëzuar pranë KPK-së 220 raporte të analizimit të aftësive profesionale dhe kjo përbën pothuajse 50% të të gjithë subjekteve që kanë paraqitur formularin e rivlerësimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ndërkohë Këshilli ka ndërmarrë një numër masash emergjente, me qëllim lehtësimin e efekteve të krijuara në gjykatat e vendi nga mungesa e burimeve njerëzore në sistem, dorëheqjeve dhe shkaqeve të tjera, dhe në projekt-raport theksohen:

-1209 caktime gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme;

-transferimi i 5 magistratëve me pëlqim në gjykata të ndryshme;

-miratimi i rregullave për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve në gjykata;

- emërimi dhe caktimi në detyrë në total i 25 kandidatëve magjistratë që kishin përfunduar Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve 2018 dhe 2019;

-përcaktimi i numrit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranoheshin në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës (25 kandidatë) dhe përcaktimi i numrit të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës (25 kandidatë);

KLJGJ-ja ka miratuar “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020” në të cilin parashikohet për herë të parë hapja e procesit të vlerësimit profesional sipas skemës së re për 121 gjyqtarë në Republikën e Shqipërisë.

KLJGJ-ja ka kryer brenda 1 viti një volum të lartë pune duke verifikuar 76 kandidatë. Verifikimi i pasurisë dhe figurës është kryer për 28 kandidatët që aplikuan për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019, 25 kandidatët magjistratë që përfunduan studimet në këtë shkollë gjatë vitit 2018-2019 si dhe 23 kandidatët që aplikuan për anëtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur.

Në funksion të garantimit të transparencës, Këshilli i Lartë Gjyqësor krijoi një faqe interneti të përkohshme si dhe caktoi z. Muharremaj për të mbuluar marrëdhëniet me publikun.

Me qëllim këshillimin dhe zgjidhjen e çështjeve etiko-morale gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, Këshilli ka emëruar gjyqtaren znj. Albana Boksi në funksionin e Këshilltarit të Etikës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka hartuar rregulloren mbi “Procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit” e cila është në fazë konsultimi dhe pritet të miratohet shumë shpejt.

KLJGJ-ja ka zhvilluar një gamë të gjerë aktiviteteve në të cilat përfshihen rreth 30 takime dy dhe shumëpalëshe, konferenca, simpoziume, trajnime dhe vizita studimore me

institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile, etj., të cilat janë zhvilluar në kuadër të fuqizimit të rolit të KLGJ-së, si institucion kyç në strukturën e sistemit të drejtësisë.

Lidhur me analizën e sistemit dhe gjetjet, gjatë vitit 2019, sistemi gjyqësor është përballur me një ngarkesë pune në rritje, ku numri i çështjeve të regjistruara në vitin 2019 është 3,37% më i lartë se në vitin 2018 dhe 11,44% më i lartë se në vitin 2017. Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 306 gjyqtarë. Sistemi gjyqësor ka zgjidhur mesatarisht 448,3 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje prej 31% krahasuar me mesataren e një viti më parë, që ishte 310,8 çështje të zgjidhura për gjyqtar në vit.

KLGJ-ja angazhohet që gjatë vitit 2020, të punojë për përmbushjen e një sërë detyrash, ku ndër prioritetet kryesore theksohen:

Vazhdimi i zbatimit të reformës në drejtësi përmes hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore të nevojshme për konsolidimin institucional të KLGJ-së në përputhje me praktikatat e mira të punës së evidentuara nga organet e tij vendimmarrëse;

Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione të lira, 3 në fushën e së drejtës administrative dhe 3 në fushën e së drejtës civile dhe plotësimi i kësaj gjykate në një kohë sa më të shpejtë me të paktën 10 gjyqtarë.

Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë për 5 pozicione të lira, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 5 pozicione të lira, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe emërimin me prioritet të gjyqtarëve të cilët konfirmohen në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar;

Vijimi i bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar;

Nisja dhe përfundimi i procesit të vlerësimit etik-profesional të 121 gjyqtarëve, sipas programit të vlerësimit për vitin 2020;

Përfundimi i analizës për rikonfigurimin e hartës gjyqësore dhe miratimin e propozimit/eve në KLGJ, si dhe nisjen e një procesi të ngushtë konsultimesh me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave me qëllim miratimin e një harte të re gjyqësore të dakordësuar me të gjithë aktorët që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe kjo me mbështetjen e partnerëve tanë

ndërkombëtarë;

Përfundimi i emërimit dhe caktimit në detyrë të magjistratëve që do të përfundojnë studimet në vitin 2020;

Verifikimi dhe konfirmimi në detyrë të kancelarëve, në përputhje me Rregulloren e miratuar në Këshill;

Hartimi i rregullores së brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të funksionimit të Komisioneve të Përhershme;

Hartimi, konsultimi, miratimi dhe shpërndarja e rregullave të etikës për gjyqtarët si dhe përpilimin e manualit praktik zbërthyes të këtyre rregullave;

Mbështetja për Këshillat e Gjykatave si organe të reja që do t'i shërbejnë miradministrimit në çdo gjykatë nëpërmjet takimeve periodike me kryetarët e gjykatave dhe miratimi i rregullave për nëpunësit gjyqësor.

Kërkesat që KLGJ-ja i parashtron Kuvendin nëpërmjet këtij projekt-raporti janë: Përmirësimi i kuadrit ligjor nëpërmjet rishikimit, më veçanërisht të ligjeve nr. 115/2016, e nr. 96/2016 dhe nr. 98/2016, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve të nevojshme që kanë lindur apo që mund të lindin gjatë zbatimit të tyre në praktikë; Rritja e burimeve njerëzore në gjykata me të paktën 100 punonjës për administratën gjyqësore në shkallë vendi, kur nevojat e raportuara vlerësohen në të paktën 330 punonjës; Mbështetja financiare në investime për rikonstruksionin apo ndërtimin e gjykatave, veçanërisht ato të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore - tërmeti i muajit nëntor 2019, si dhe sisteme bashkëkohore të teknologjisë së informacionit, veçanërisht për krijimin e një Sistemi të ri për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore si dhe mirëmbajtjen e sistemeve aktuale të gjykatave deri në krijimin e këtij të fundit.

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Zoti Toro në përfundim të relatimit bën një propozim sa i përket investimit të Parlamentit në të ardhmen për rritjen e pagave të gjyqësorit dhe kjo të shtohet në projekt-raport.

Zonja Llagami, pasi shprehet në lidhje me propozimin e zotit Toro për ta adresuar

atë në pjesën e propozimit të rishikimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor nga ana e Kuvendit, hedh në votim miratimin e projektvendimit “Për miratimin e Raportit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor 2019”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord pjesërisht, për propozimin e bërë më lart.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Miratimin e “Raport mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2019”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.05.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor, sipas aktit normative nr.15/2020”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*
9. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor, sipas aktit normative nr.15/2020”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Lidhur me detajimin e këtij projekt-akti, relaton zonja Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë KLGJ-së.

Në fjalën e saj zonja Laze shprehet se Ministria e Financave ka dërguar pranë KLGJ-së shkurtimin e fondeve për buxhetin e sistemit gjyqësor, në të dy programet buxhetore, 19 milion lekë për KLGJ-në në shpenzime personeli dhe 90 milion lekë për buxhetin gjyqësor në shpenzime personeli dhe shpenzime operative. Zonja Laze sqaron

se detajimi sa i përket shpenzimeve të personelit për buxhetin e KLGJ-së dhe buxhetin e gjykatave është pasqyruar në Tabelën nr. 1, bashkëlidhur materialit. Ndërsa në kuadër të shpenzimeve operative sugjerohet që të miratohen shkurtime të fondeve 3 600 000 lekë për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës, për gjyqtarët e gjykatave të Posaçme (fond i programuar për shkak të VKM-së); shkurtime të fondeve 2 200 000 lekë që ka të bëjë me mirëmbajtjen e sistemit “Alfa Web”; shkurtime të fondeve 5 000 000 lekë nga Gjykata e Lartë.

Në përfundim, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, bazuar në Aktin Normativ nr.15/2020, i propozon mbledhjes plenare miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i projektvendimit “Mbi miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor, sipas aktit normative nr.15/2020”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 19 000 000 lekë, në artikullin

shpenzime personeli (sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur). 2. Miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i gjykatave, për shumën prej 60 000 000 lekë, në artikullin shpenzime personeli (sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur) dhe në shumën 30 000 000 lekë, në artikullin shpenzime operative (sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur). 3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.05.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
- 8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*
- 9. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Sa i përket detajimit dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata për vitin 2020, zonja Llagami i jep fjalën zonjës Ejona Isufaj, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së.

Në parashtrimin e saj, zonja Ejona Isufaj shprehet se KLGJ-ja, gjatë projektbuxhetit për vitin 2020, i ka kërkuar Ministrisë së Financave 82 punonjës me kontratë të përkohshme, ndërkohë që Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 47, të ndryshuar, miratoi 36 punonjës. Pas miratimit të këtij numri, ky Departament analizoi situatën e punonjësve në gjykata duke detajuar: numrin e sekretarëve gjyqësorë si vijon:

Gjykata e Apelit Gjirokastër (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (1); numrin e nëpunësve gjyqësorë si vijon: Gjykata e Apelit Vlorë (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë (1); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2); numrin e sanitarëve si vijon: Gjykata Apelit Durrës (1); Gjykata Apelit Shkodër (1); Gjykata Apelit Tiranë (1); Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan (1); Gjykata Rrethit Gjyqësor Fier (1); Gjykata Rrethit Gjyqësor Korçë (1); Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër (1); Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë (1); Gjykata Rrethit Gjyqësor Vlorë (1); Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (1); numrin e mirëmbajtësve si vijon: Gjykata Apelit Shkodër (1) dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (1).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, prandaj hidhet në votim miratimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata për vitin 2020”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Të miratojë detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata, sipas tabelës bashkëlidhur këtij

vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.05.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i shqyrtimit të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë të z.{...} si anëtar i Gjykatës së Lartë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Luljeta Laze, Drejtoreshë e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Ejona Isufaj, Drejtoreshë e Departamentit të Burimeve Njerëzore.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
7. *Përfaqësues të Projektit “Drejtësi për të gjithë”.*
8. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS.*
9. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

4. Vijimi i shqyrtimit të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me Shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë.

Çështja në fjalë është vijim i mbledhjes plenare të datës 27.04.2020, në përfundim të të cilës, me shumicë votash, anëtarët vendosën që të merrej një opinion nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjet e shtruar për diskutim nga ana e Këshillit. Në atë mbledhje Komisioni i Zhvillimit të Karrierës parashtroi relacionin, në konkluzion të të cilit dolën disa çështje të cilat duhet të trajtoheshin nga ana e Këshillit. Pas marrjes edhe të përgjigjes nga ana e gjyqtarit një ditë më parë, *zonja Marçela Shehu* propozon që

çështjet të shtrohen për diskutim dhe secili anëtar të japë opinionin e tij.

Zoti Ilir Toska merr fjalën për të sugjeruar dhënien e relacioneve shpjegues të vendimmarrjeve për shpalljet e pozicioneve të lira të muajit korrik dhe të muajit shtator 2019 si dhe korrespondencën me Presidentin e Republikës në mars të 2020, duke qenë se nga letra e gjyqtarit konstatohet se ai nuk njeh arsyetimet e vendimmarrjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastin e shpalljes së 4 pozicioneve të lira për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur si dhe nuk njeh as korrespondencën e bërë nga Këshilli me Presidentin e Republikës në lidhje me 3 propozimet për emërim në Gjykatën e Lartë të 3 gjyqtarëve. Sa më sipër, t'i jepet edhe një herë mundësi gjyqtarit për të dhënë opinionin e tij e në rast të kundërt, Këshilli të vijojë me qëndrimin e tij.

Zoti Erjon Muharremaj merr fjalën në vijim dhe sugjeron që opinionin në lidhje me qëndrimin në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të kërkohet edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Dhe i pyetur nga zonja Fatmira Luli për problemi ligjor që Këshilli duhet të kërkojë konkretisht nga partnerët ndërkombëtarë, ai e me pikën 5 të nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit”. A konsiderohet i emëruar pasardhësi në rastin konkret me emërimet që janë bërë në Gjykatën e Lartë? Ky sugjerim nga zoti Muharremaj vjen për të pasur parasysh ekonominë kohore.

Lidhur me sa më sipër **zonja Shehu** shprehet se fillimisht Këshilli duhet të diskutojë nëse e ka të qartë kuptimin e interpretimit të pikës 5 të nenit 136 të Kushtetutës dhe nëse do të kihet paqartësi atëherë të rivlerësohet marrja e vendimit nga ana e partnerëve ndërkombëtarë.

Pas propozimeve të bëra nga zoti Toska dhe zoti Muharremaj, Kryetarja e Këshillit hedh fillimisht në votim propozimin e bërë nga zoti Toska, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër, për të njëjtën arsye që ka thënë edhe në seancën e

kaluar, pasi është e mendimit që nuk kishte arsye ligjore që kjo situatë duhet t'i njoftoheshe z. {...}. Pra është kundër.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër, për arsye se sipas tij gjyqtari ka pasur mundësi t'i kërkojë Këshillit materialet e nevojshme (edhe pse kanë qenë publike), si dhe për faktin se sipas tij ai vazhdon të ushtrojë një detyrë/shërbim të pa kërkuar.

Fatmira Luli është dakord, me arsyetimin që meqenëse i është komunikuar relacioni dhe gjetjet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, atëherë është mirë që të njihet edhe me materialet dhe relacionet e mëparshme që janë zhvilluar për këto vende vakante.

Marçela Shehu është kundër, me të njëjtin arsyetim që ka qenë edhe në mbledhjen e kaluar, ku shumica vendosi që t'i bënte me dije dhe të njihete zotit {...} me shkresën e Presidentit dhe me relacionin e përgatitur nga Komisioni, pasi vlerëson se nuk ndodhet Këshilli përpara situatës së një vendimmarrjeje (para një procesi administrativ), ndaj njoftimi në fillim i zotit {...} me aktet si dhe ajo çka po procedohej në Këshill dhe në vijim është i padobishëm.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord, për të respektuar të drejtën dhe për të shfaqur mendimin, subjekti i interesuar në procedurën administrative, duhet të njihet me të gjitha materialet e çështjes.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Këshilli me shumicë votash vendosi t'i përcjellë zotit {...} të gjithë dokumentacionin që Këshilli ka lidhur me procesin e ndjekur lidhur me dekretimin e tre gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

Më pas hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga zoti Muharremaj, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është kundër, për arsyen që tha edhe më sipër për procedurë, por edhe për faktin që sërish për faktin që e ka shkrehur mendimin e saj dhe e ka shumë të qartë interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjit. Anëtarët që e kanë të paqartë, siduket kanë nevojë për të marrë mendimin e të tjerëve, - shton zonja Kadi.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord për hir të praktikës dhe për sa një anëtar i Këshillit e konsideron të nevojshme edhe pse vetë ai e ka të qartë rastin.

Alban Toro është kundër për shkak se bëhet fjalë për vlerësim faktesh dhe për zotin Toro rasti është i qartë.

Fatmira Luli është kundër pasi mendon që nuk ka ndonjë problem ligjor lidhur me ato që kanë ndodhur.

Marçela Shehu është kundër pasi në Këshill nuk është ngritur si problematikë kuptimi i pikës 5 të nenit 136 të Kushtetutës, ndërkohë që përveç kësaj, nuk e di sa do të ishin të gatshëm misionet do të përgjigjeshin në këtë rast, kur nuk po kërkohet thjesht interpretimi i pikës 5 të nenit 136, por kërkohet interpretimi dhe përcaktimi i kuptimit të kësaj pike në lidhje me emrin e një magjistrati. Nga historiku i komunikimeve që Këshilli ka pasur me të dy misionet, personalisht zonja Shehu ka vërejtur që të dyja misionet kanë pranuar se nuk është në misionin e tyre që të japin mendime, sidomos në rastet kur janë të personalizuar.

Erjon Muharremaj është dakord, me arsyetimin që ka bërë edhe në fillim kur bëri propozimin por shton që gjithmonë kërkesa vjen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si institucion në kuptim edhe të angazhimit që kanë pasur të dy partnerët ndërkombëtarë, si në draftimin e legjislacionit, ashtu edhe në mbështetjen që kanë dhënë gjatë gjithë veprimtarisë së Këshillit.

Brikena Ukperaj është dakord, me të gjithë arsyetimin që dha zoti Muharremaj.

Medi Bici është dakord, me të njëjtin arsyetim.

Naureda Llagami është dakord, me të gjithë argumentimet që ai dha.

Me shumicë votash Këshilli vendosi që t'i kërkojë një opinion Misionit

EURALIUS dhe Projektit të USAID-it lidhur me çështjen që u propozua.

Në përfundim, zonja Llagami propozon shtyrjen e trajtimit të çështjes derisa Këshillit t'i vijë në dispozicion opinioni nga partnerët ndërkombëtarë dhe ndërkohë zotit {...} t'i bëhet me dije dokumentacioni përkatës.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor